



REPUBLIKA E SHQIPERISE
QARKU ELBASAN
KOMUNA KUSHOVE – GRAMSH

Kushove me date 24.08.2013

KONTRATE SHERBIMI
Per Mbikqyrje Punimesh per objektin

“Rikonstruksion shkolla 9 – vjecare Sotire,” Komuna Kushove ,Gramsh

Bazuar ne Ligjin Nr. 8402 , date 10.09.1998 “ Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit “ si edhe ne U K M Nr.3 , date 15.02,2001(i ndryshuar) , Udhezimeve Te Keshillit te Ministrave Nr.4 , date 17.05.2001 , Nr.7 , date 20.11.2001 , Nr.2 , date 13.05.2005“ Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit “.

Kjo kontrate lidhet sot me date 24.08.2013 , prane Autoritetit Kontraktues ne mbeshtetje te kontrates se lidhur ndermjet **Komunes Kushove ,Gramsh** ,ne rolin e investitorit dhe shoqerise “ _____ “ sh.p.k , ne rolin e Sipermarresit per zbatimin e punimeve te objektit te kontrates se mesiperme . **Komuna Kushove ,Gramsh** me te drejten e Investitorit ne mbeshtetje te dispozitave ligjore per drejtimin dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit (**Kryetari i Autoritetit Kontraktues**) cakton **Mbikqyrese te Punimeve Zj. Natasha Myrtaj(Metohu)** , me adrese Tirane, Lagja Nr.5.

PALET KONTRAKTUESE
NENI 1

Autoriteti Kontraktor ,Komuna **Kushove ,Gramsh**, perfaqesuar nga kryetari i saj z. **Xhevair Bora** me adrese Qender e fshatit Kushove , Rrethi Gramsh , ketu me poshte I quajtur Autoriteti Kontraktor
Dhe

Ing.Natasha Myrtaj , me adrese Tirane, Lagja Nr.5 , e emeruar **Mbikqyrese Punimesh e pajisur me Licence me Nr. MK0992/2** , leshuar me date 05.12.2011 nga Ministria Puneve Publike Transport Telekomunikacionit , NIPT K37509823M

NENI 2
OBJEKTI I KONTRATES

2.1 Objekti I kesaj kontrate jane marredheniet juridike qe krijohen midis Investitorit Komuna **Kushove ,Gramsh** dhe mbikqyreses se punimeve te caktuar , personit fizik **IngNatasha Myrtaj (Metohu)** me Licence me Nr. MK0992/2 leshuar me date 05.12.2011 nga Ministria Puneve Publike Transport Telekomunikacionit per mbikqyrjen e punimeve te

NATASHA MYRTAJ
PROJEKTIM DHE
KOLAUDIM

ndertimit te objektit “Rikonstruksion shkolla 9 – vjecare Sotire,” Komuna Kushove ,Gramsh

2.2 Operatori ekonomik (Sipermarresi i punimeve) per objektin e mesiperm qe ka lidhur kontrate me Komunen, **Kushove ,Gramsh** eshte ” _____ “ sh.p.k

NENI 3

DETYRIMET E MBIKQYRESIT TE PUNIMEVE

- 3.1 ZnjNatasha Myrtaj(Metohu) e emeruar Mbiqyrese puunimesh per objektin e kesaj kontrate ,me firmosjen e saj ka deklaruar se : Nuk kam lidhje pune ,gjaku apo interesash me firmat sipermarresete objektit te kesaj kontrate:
- 3.2 Mbiqyresi i punimeve me shpenzimet e veta ndjek kontrollin e zbatimit te punimevedhe ecurine sipas grafikut te objektit te kontrates .
- 3.3 Mbiqyresi i punimeve eshte i detyruar te marre pjese ne kolaudimin e punimeve dhe te firmose proces verbalin e kolaudimit.
- 3.4 Mbiqyresi i punimeve duhet te kontrolloje llogatitjet metrike ne librezen e masave qe mbahet nga Operatori ekonomik.
- 3.5 Mbiqyresi i Punimeve njofton me shkrim per cdo problem qe mund te lind gjate zbatimit te punimeve.
- 3.6 Mbiqyresi i Punimeve kontrollon dhe miraton situacionet e paraqitura nga sipermarresi dhe pas kesaj ato kalojne per pages Investitorit
- 3.7 Ne perfundim te periudhes se garancise se difekteve , Investitori , Kolaudatori Mbiqyresi i Punimeve dhe Sipermarresi bejne kontrollin perfundimtar te vepres. Per defektet qe nuk jane riparuar gjate periudhes se garancise se punimeve investitori llogarit koston e riparimit dhe bene ndalesen nga vlera e garancise se punimeve .
- 3.8 Ne perfundim t e punimeve Mbiqyresi i Punimeve duhet ti paraqese Investitorit dokumentacionin teknik te zbatimit te punimeve te sipershenuara te mara ne dorzim nga Sipermarresi se bashku me relacionin e vet.

NENI 4

DOKUMENTACIONI QE PERPILOHET

4.1 Mbiqyresi i punimeve harton dokumentacionin sipas kerkesave te :

- a. Ligjit **Nr 8402** date 10.09.1998 “ Per Kontrollin e Punimeve te Ndertimit” me ndryshimet perkatese .
- b. Udhezimit **Nr.3 date 15.02.2001** te Keshillit te Ministrave pika I “ Per Mbiqyrjen e Punimeve te Ndertimit”ndryshuar me UKM Nr.1 date 16.06.2011.

4.2 Mbiqyresi i punimeve mban dosjen e vecante ku percaktohet e gjithë veprimtaria e tij gjate mbikqyrjes se punimeve dhe ne perfundim ia dorezon ate Autoriteti kontraktor.

4.3 Mbiqyresi i punimeve me miratimin te Autoritetit Kontraktor ushtron te gjitha kompetencat qe i ofron Udhezimi Nr 3 date 15.02.2001 i Keshillit te Ministrave si dhe UKM nr 5 date 13.05.2005.

4.4 Mbiqyresi i Punimeve duhet ti kerkoje Operatorit ekonomik dokumentacionin e punimeve te maskuara me fotografi.

NENI 5

DETYRIMET E AUTORITETIT KONTRAKTOR

Autoriteti kontraktor Komuna **Kushove ,Gramsh** ne cilesine e investitorit ka per detyrim ndaj mbikqyresit te punimeve :

5.1. Te liroj sheshin e ndertimit per punimet qe do te realizohen.

5.2. Te vere ne dijeni mbikqyresin e punimeve per te gjitha ndryshimet qe mund te ndodhin ne dokumentacionin teknik , si edhe te gjithe dokumentacionin e nevojshem te kerkuar prej mbikqyresit te objektit .

5.3 Te beje pagesen e plote te mbikqyresit ne perputhje me oferten fituese te procedures me blerje te vogel ne sistemin elektronik , ne shumen :

- **34.900 (tridhjetë e katermijë e nentëqinde) leke pa TVSH ose**
- **41.880 (dyzete e nje mije e teteqinde e tetedhjet)leke me TVSH**

Kjo pagese do te behet sipas situacioneve te likujduara mujore

Ky shperblim do te kaloje ne Nr. E llog 049988 ,

IBAN AL1420211192000000000049988 Banka "Raiffeisen Bank "SHA

5.4 Financimi I vleres sipas pikes **5.3** te mesiperme behet sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Po keshtu autoriteti kontraktor ka te drejte :

5.5. Te kerkoj ne cdo kohe informacion per ecurin e punimeve ne object .

5.6. Te zevendesoj mbikqyresin e punimeve kur veren mangesi serioze ne veprimtarine e tij.

NENI 6 **TE NDRYSHME**

6.1 Dokumentacioni perberes i kesaj kontrate eshte:

- a. Fotokopja e ligjit Nr **8402 date 10.09.1998** " Per kontrollin e punimeve te ndertimit" me ndryshimet perkatese.
- b. Fotokopja e Udhezimit Nr **3 date 15.02.2001** te Keshillit te Ministrave pika I "Per Mbikqyrjen e Punimeve te Ndertimit ".
- c. Fotokopja e licences se noterizuar e mbikqyresit te punimeve per mbikqyerje punimesh.
- d. Fotokopja e kontrates mbajtur midis investitorit dhe sipermarresit .oferta e sipermarresit , projektet apo skicat e punimeve , specifikimet teknike te punimeve dhe grafiku i punimeve.

6.2 Mosmarreshjet qe lindin midis paleve zgjidhen me mirekuptim , ne rasat te kundert kopetente per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata e Rrethit Gramsh.

6.3 Kjo kontrate mbahet ne kater kopje originale dhe perbehet nga 4 (kater) flete , firmoset e vuloset dhe nje origjinal i jepet mbikqyresit te punimeve.

PALET

Mbikqyresi i Punimeve

Ing.Natasha MYRTAJ

PROJEKTI DREJTIN
KONSTRUKCIM



AUTORITETI

Komuna Kushove - Gramsh

Kryetari

Xhevair BORA